



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-06
Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatësi Nikola Giju

Administratorja: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 23 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Parashtrime të Prokurorisë pas konferencës së 18 nëntorit 2020 mbi ecurinë e çështjes

Prokurori i Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtësit të Jakup Krasniqit
Venkateswari Alagendra

1. Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) ofron parashtrime shtesë me shkrim lidhur me çështjen e datës së përshtatshme të gjyqimit të kësaj çështjeje.
2. Në kuadër të konferencës mbi ecurinë e çështjes së datës 18 nëntor 2020, mbrojtësit e të akuzuarve (bashkërisht “Mbrojtja”) këmbënguli për një shtyrje të gjatë të fillimit të gjyqimit. Në parashtrimin e tij me shkrim, mbrojtësi i z. Veseli pretendonte se data më e hershme e mundshme e nisjes së gjyqimit do të ishte qershori i 2022.¹ Më pak se 15 orë pasi kishte shprehur këtë qëndrim, mbrojtësi njoftoi pikërisht në konferencën mbi ecurinë e çështjes, se meqë “gjërat e kanë zakon të mos ecin sipas planit,” në fakt ai po sugjeronte që gjykimi të fillojë 18 muaj pas propozimit të datës 31 maj 2021, data e nxjerrjes së materialeve nga ZPS-ja sipas rregullës 102(1)(b),² ose efektivisht në janar të vitit 2023.³ Mbrojtësit e tjerë ose propozuan data të ngjashme të largëta për fillimin e gjyqit, ose u bënë bashkë duke këmbëngulur për datën (datat) e ofruar nga mbrojtësi i z. Veseli.
3. ZPS-ja ka një interes të thellë dhe të palëkundur që Mbrojtja të ketë kohë dhe mjete të mjaftueshme për t’u përgatitur. ZPS-ja është plotësisht e interesuar që ky proces gjyqësor të kryhet me transparencë dhe drejtësi për të gjitha palët, në mënyrë që rezultati i këtij gjykimi të jetë i qëndrueshëm dhe të perceptohet si i drejtë nga të gjithë ata që do ta shqyrtojnë çështjen me objektivitet. Megjithatë, vonesat e mëdha të kërkuar me ngulm nga Mbrojtja nuk janë as të përligjura, as në përputhje me interesin e proceseve të shpejta apo të drejtat e dëshmitarëve dhe viktimave në këtë çështje, sikurse njihen edhe në ligj.⁴

¹ Parashtrime në emër të Kadri Veselit: Konferenca mbi ecurinë e çështjes – e mërkurë, 18 nëntor, KSC-BC-2020-06/F00087, 9 nëntor 2020 (“Parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit”), para. 6.

² Rregullorja e Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 (“Rregullorja”). Të gjitha referencat “rregulla” ose “rregullat” këtu i referohen Rregullores, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

³ Transkripti i konferencës mbi ecurinë e çështjes, 18 nëntor 2020, f.108.

⁴ Ligji nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 (“Ligji”), Neni 1 (që rendit ndër qëllimet e Ligjit sigurimin e “procedurave penale të drejta dhe efikase”), Nenet 22-23 (përcaktojnë të drejtat dhe mbrojtjet e viktimave dhe dëshmitarëve). Të gjitha referencat “neni” ose “nenet” këtu i referohen neneve të Ligjit, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

4. Mbrojtësit e bazuan kërkesën e tyre për një shtyrje të gjatë tek neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila parashikon të drejtën e një të akuzuari për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij (që parashikohet edhe në nenin 30 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 21 të Ligjit). Por, përdorimi i kësaj dispozite nuk është në vetvete një fjalëkalim magjik. Mbrojtja nuk ka mundur të provojë mjaftueshëm nevojën për një shtyrje kaq të gjatë (qoftë deri në qershor 2022, apo në janar 2023). Gjithashtu, argumentet e paraqitura nga mbrojtësit nuk u bënë më të mira me anë të përdorimit të gjuhës shpesh emotive dhe panevojshmërisht personale gjatë përcjelljes së tyre.

5. Së pari, kërkesa për një shtyrje të konsiderueshme duket qartë se përdoret për një qëllim kryesisht strategjik që e tejkalon nevojën legjitime të përgatitjes për gjykim. Mbrojtja vetë e ka pranuar hapur se kërkesa e saj për një shtyrje të gjatë të fillimit të gjykimit mund të përdoret për të forcuar bazën e dëshirës parësore të saj, sigurimin e lirimit të përkohshëm. Mbrojtësi i z. Veseli ndërkohë e bëri këtë të njohur, duke e parashtruar përpara konferencës mbi ecurinë e çështjes, duke i lidhur shprehimisht të dy çështjet dhe duke e përsëritur këtë pikë përsëri gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes.⁵ Pra, që në fillim justifikohet skepticizmi i konsiderueshëm ndaj pretendimit të Mbrojtjes se i duhen deri në dy vjet për t'u përgatitur për këtë gjykim. Njeriu mund të mendojë se qëndrimi i Mbrojtjes do të evoluojë dhe befas ajo do ta gjejë mënyrën për t'u përgatitur shumë më shpejt, nëse gjykata do të vendoste të vazhdonte paraburgimin e të akuzuarve në pritje të gjykimit, sikurse është kërkuar nga ZPS-ja.

6. Së dyti, mbrojtësit e të akuzuarve pretendojnë se u duhen vite për t'u përgatitur për gjyq për shkak të kohës që ka pasur ZPS-ja për të hetuar çështjet e saj. Kjo kërkesë është thjeshtëzuese dhe krejtësisht e gabuar. Gjatë kohës deri sa erdhëm tek kjo çështje, ZPS-ja ka hetuar jo vetëm këta katër të akuzuar, por raste, të akuzuar, incidente, dhe teori përgjegjësie të shumta. Gjithashtu ajo përballet me një detyrim të ndryshëm

⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit, KSC-BC-2020-06/F00087, para. 10, 15; Transkripti i konferencës mbi ecurinë e çështjes, 18 nëntor 2020, f.176.

prove nga Mbrojtja dhe ka një mision shumë të ndryshëm. ZPS-ja ka për detyrë të kontribuojë për të provuar të vërtetën,⁶ një detyrë shumë më e rëndë se sa ajo e mbrojtësve, e cila është vetëm të mbrojnë me sukses interesat e klientëve të tyre individualë.

7. Për më tepër, ZPS-ja i ka kryer hetimet në një atmosferë që shpesh është armiqësore ndaj punës së saj dhe është përballur me rezistencë dhe përpjekje aktive për minimin e hetimit të saj. Me siguri edhe Mbrojtja do ta pranojë se të akuzuarit në këtë çështje do të hasin një dinamikë tepër të ndryshme kur ata të kryejnë hetimet e tyre në Kosovë. Si rrjedhojë, kohëzgjatja e hetimeve të ZPS-së nuk ofron konkretisht asnjë udhëzim lidhur me kohën që duhet t'i jepet Mbrojtjes.

8. Së treti, mbrojtësit u mbështetën në shembuj nga çështjet e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) për pretendimin se u duhen lejuar vite për t'u përgatitur për çështjen e tyre. Ky krahasim mund të duket në sipërfaqe tërheqës, por në fund të fundit është i pavend.

9. Çështjet e TPNJ-së u gjykuan nga tribunali i parë ndërkombëtar që u themelua që pas Tribunalit Ushtarak Ndërkombëtar në Nuremberg, dhe dy çështjet e para që kishin të bënin me UÇK-në ishin ndër të parat çështje që u ngritën kundër ish-anëtarëve të UÇK-së. Shumë është mësuar që atëhere për të siguruar që proceset të jenë më efikase dhe të shpejta, duke qenë përherë të drejta, dhe kjo gjykatë ka kërkuar të nxjerrë mësim nga tribunalët që i kanë paraprirë dhe jo thjesht të barazohet me punën e tyre, por të punojë shumë më mirë.

10. Hollësitë dhe konkretësia e Aktakuzës, vëllimi i provave në mbështetje të akuzave dhe përshkrimi i hollësishëm që tregon lidhjen me to, në veçanti për sa i takon sjelljes së të akuzuarve, sikurse parashikohet nga korniza ligjore dhe normative e gjykatës, i ofrojnë në tërësi Mbrojtjes shumë më tepër material dhe në një fazë më të hershme se sa në kontekstin e TPNJ-së. Sikundër ZPS-ja shpjegoi në konferencën mbi ecurinë e çështjes, Mbrojtja do të marrë një pjesë shumë të madhe të provave që

⁶ Rregulla 62.

mbështesin aktakuzën e ZPS-së brenda tridhjetë ditësh nga paraqitja e parë e të akuzuarve dhe brenda muajsh do të marrë praktikisht të gjithë materialin që do të bëhet i njohur në këtë çështje.

11. Për këto arsye, nuk ka ndonjë mister për Mbrojtjen lidhur me çështjen e ZPS-së dhe hetimet dhe përgatitjet e saj mund të nisin menjëherë. Nga aktakuza e hollësishme dhe nxjerrja e hershme e materialeve, Mbrojtja do to njoftohet lidhur me çështjen me të cilën do të përballet në gjyq. Për më tepër, ndryshe nga çështjet në TPNJ, kjo çështje përfshin shumë krime të cilat ndërkohë janë gjykuar në Kosovë dhe në TPNJ gjatë procedimeve të publikuara më së miri, të cilat janë sigurisht të njohura për të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre. Për më tepër, në kontakt të intervistave hetimore, të gjithë të akuzuarit në këtë çështje janë njoftuar muaj më parë se ishin të dyshuar në hetimet e ZPS-së dhe dy prej të akuzuarve e kanë ditur që në qershor se ZPS-ja kishte paraqitur një aktakuzë për konfirmim kundër tyre. Ka prova se të paktën njëri prej të akuzuarve i ka ndjekur aktivisht veprimtaritë hetimore në vazhdim të ZPS-së.⁷

12. Prandaj, nuk është çudi që disa prej të akuzuarve kanë pasur mundësi të vendosin për mbrojtjen e tyre. Megjithëse mbrojtësi i z. Veseli ishte më aktiv në ngulmimin e tij për shtyrje të gjatë të procesit, ai gjithashtu nuk pati asnjë vështirësi të shpjegonte linjat kryesore të mbrojtjes së tij në parashtrimin përpara konferencës mbi ecurinë e çështjes, dhe pastaj t'i përsëriste ato në vetë konferencën mbi ecurinë e çështjes, pavarësisht nga udhëzimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për mbrojtësit për të mos ridekluaru qëndrimet e tyre të bëra të qarta ndërkohë nga parashtrimet. Po ashtu, në intervistën e tij me ZPS-në, zoti Thaçi nuk pranoi asnjë përgjegjësi për krimet e kryera nga anëtarët e UÇK-së, duke deklaruar në mënyrë të përsëritur se në asnjë moment, në 1998 apo në 1999, as ai, as ndonjë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, nuk kishin asnjë autoritet mbi UÇK-në. Sikurse u vu në dukje në konferencën mbi ecurinë e çështjes, këto pohime përgënjeshtrojnë edhe më tej

⁷ *Shih* versionin e redaktuar konfidencial të 'Kërkesës për fletarrestime dhe urdhra në lidhje me to', KSC-BC-2020-06/F00005/CONF/RED, 14 nëntor 2020, para 10-17 dhe burimet e cituara aty. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06/F00005/ /RED.

pretendimet e Mbrojtjes se përgatitjet dhe hetimi nuk mund të fillojnë përveçse pas njëfarë kohe, pas nxjerrjes së të gjitha materialeve.

13. Së fundi, përveçse të sigurojë që Mbrojtja të ketë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur, Gjykata ka për detyrë të sigurojë procedura gjyqësore të shpejta dhe të mbrojtë të drejtat dhe interesat e viktimave dhe dëshmitarëve. Megjithëse mbrojtësit u mbështetën në shembullin e çështjeve të TPNJ-së për të kërkuar shtyrje të këtyre procedurave, ata nuk përmendën fare sidomos problemet e frikësimit në shkallë të gjerë të dëshmitarëve që rrethojnë këto çështje. Prokuroria kundërshton zgjatjen e periudhës së kohës midis përfundimit të nxjerrjes së materialeve prej saj dhe fillimit të gjykimit në një masë të madhe, sepse nuk ka as më të voglin dyshim se dëshmitarët do të vihen në rrezik të madh trysnie dhe frikësimi gjatë kësaj periudhe. Shtyrja e gjykimit për vite jo vetëm nuk do të sigurojë realizimin e drejtësisë sa më shpejt, por do ta bëjë të pamundur realizimin e saj.

14. Korniza ligjore dhe normative e kësaj Gjykate kërkon realizimin e shpejtë dhe me paanësi të drejtësisë, duke vendosur detyrime të rrepta për prokurorinë lidhur me provat që mbështetin aktakuzën, formën e akuzave dhe nxjerrjen e materialeve. Si rrjedhojë, ai parashikon që vetë procedurat gjyqësore të zhvillohen me shpejtësi dhe efikasitet. Në veçanti, neni 39(1) krijon një obligim të dyfishtë për Gjykatësin e Procedurës Paraprake "për të siguruar që çështja të përgatitet si duhet dhe me shpejtësi për gjykim". Gjithashtu, rregulla 102(1)(b) parashikon qartë një kohë relativisht të shkurtër midis dhënies së listave të dëshmitarëve dhe provave materiale nga ZPS-ja dhe nisjes së gjykimit. Megjithatë, Mbrojtja kërkon të marrë të gjitha përfitimet e këtij sistemi të ndërtuar me kujdes, pa përmbushur asnjë prej detyrimeve të saj. Mbrojtja është e kënaqur që ZPS-ja të përmbushë detyrimet e saj sipas Ligjit dhe Rregullores, duke përfshirë lidhur me akuzat dhe nxjerrjen e materialeve, por nga ana tjetër kërkon zvarritjen e procesit për një periudhë të zgjatur, gjatë të cilës dëshmitarët do të hasin rreziqe gjithnjë e më të mëdha frikësimi. Mbrojtja duhet të ketë një mundësi të drejtë për t'u përgatitur për gjyq, por duke pasur parasysh materialet që i janë dhënë dhe do t'i jepen dhe ato që janë tashmë të njohura për të, kjo

do të kërkonte muaj, por jo vite. Për këtë arsye ZPS-ja parashtron se gjykimi i kësaj çështjeje duhet të fillojë këtë verë, apo jo më vonë se shtatori i 2021.

Numri i fjalëve (në origjinal): 1732

/nënshkrim/

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

E hënë, 23 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë.